



WIEN IST VIELFALT. MA 17

MA 17 – Cështjet e integritit dhe të larmishmërisë

Në administratën e Qytetit të Vjenës Seksioni 17 i Bashkisë është kompetent për organizimin e masave dhe të projekteve për nxitjen e barazisë së të drejtave dhe të shanseve të imigranteve dhe të migrantëve. Në këtë rast i përkrah të gjithë vjenezët në krijimin e marrëdhënieve sa më të mira me njëri-tjetrin.

Përveç subvencionimit të masave të përvetësimit të gjuhës dhe të larmishmërisë Seksioni 17 i Bashkisë përkrah projekte për këshillimin, shoqërimin dhe fuqizimin e migranteve dhe të migrantëve për forcimin e pjesëmarrjes së tyre në jetën shoqërore dhe nxitjen e sensibilitetit dhe të kompetencës ndërkulturore. Një pikë qendrore e punës së seksionit është krijimi i një rrjeti dhe komunikimi i rregullt me organizatat dhe shoqatat e migranteve dhe të migrantëve.

Kontakt:

Telefoni i shërbimit: 4000 81510

Adresa: 1080 Vjenë, Friedrich-Schmidt-Platz 3

E-maili: post@ma17.wien.gv.at

Faqja e Internetit: www.integration.wien.at

Pasaporta vjeneze e arsimit – e subvencionuar me mjetet e Seksionit 17 të Bashkisë – është shoqëruesja juaj në punë dhe për arsimin në qytet.



MA 35 – Imigrimi, nënshtetësia, zyra e gjendjes civile

Seksioni 35 i Bashkisë është kompetent për imigrimin, për të gjitha çështjet e nënshtetësisë austriake dhe për zyrat e gjendjes civile në Vjenë. Jo vetëm për lëshimin e një certifikate lindjeje, por edhe për lidhjen e martesës, për lëshimin e një certifikate vdekjeje, dhënien e nënshtetësisë austriake ose për akordimin e një titulli të qëndrimit – Seksioni 35 i Bashkisë ju shoqëron të gjithë jetën në Vjenë.

Në rast të pyetjeve në lidhje me qëndrimin tuaj, mund t'i drejtoheni Qendrës së Shërbimit ndaj Klientëve të Seksionit 35 të Bashkisë, ku do të informoheni në mënyrë kompetente dhe në më shumë gjuhë.

Kontakt:

Telefoni i shërbimit: 4000 3535

Adresa: 1200 Vjenë, Dresdner Straße 93, blloku C

E-maili: service@ma35.wien.gv.at

Faqja e Internetit: www.wien.gv.at/verwaltung/personenwesen/

Nga Seksioni 35 i Bashkisë keni marrë edhe një dosje mirëseardhjeje në të cilën mund të gjeni informacione dhe adresat e institucioneve, zyrave dhe organizatave më të rëndësishme në Qytetin e Vjenës.



waff – Fondi për nxitjen e punëmarrëseve dhe të punëmarrësve të Vjenës

waff-i është një institucion i Qytetit të Vjenës për një politikë aktive të tregut të punës dhe ofron informacione të para në gjuhën tuaj amëtare mbi çështjet e punës. Në konsultimin e parë për çështjet e punës njiheni me çdo gjë që ka të bëjë me të drejtat, detyrimet dhe shanset tuaja në tregun e punës.

Veçanërisht personat që kanë ardhur para pak kohe dhe kanë hyrje të lirë në tregun e punës ose mund ta kenë brenda një viti përfitojnë nga këto informacione bazë të gjera.

Konsultimi i parë për çështjet e punës ofrohet në gjuhën shqipe, arabe, boshnjake/kroate/serbe, bullgare, kineze, gjermane, angleze, polake, rumune, ruse dhe turke.

Përveç kësaj waff-i ofron konsultime dhe subvencionime për kualifikimin tuaj të mëtejshëm profesional.

Informohuni në “startcoaching” të Seksionit 17 të Bashkisë mbi orarët më të afert në gjuhën tuaj dhe merrni pjesë në një takim të waff-i! Ose lini vetë një takim.

Kontakt:

Telefoni i shërbimit: 217 48 - 555

Adresa: waff Qëndër konsultimesh për profesionin dhe kualifikimin e mëtejshëm

1020 Vjenë, Nordbahnstraße 36/shkalla 1/kati i 4-të – 3. Stock (djathtas)

E-maili: bbe@waff.at

Faqja e Internetit: www.waff.at

waff-i është në dispozicionin tuaj edhe pas konsultimit të parë për çështjet e punës për informacione dhe përkrahje financiare në rast të masave të tjera të kualifikimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm profesional.



Beratungszentrum für Migranten
und Migrantinnen

Anerkennungs- und Weiterbildungsberatungsstelle

Konsultore për njohjen dhe kualifikimin e mëtejshëm (qëndër kompetence)

Qendra e konsultimeve për migrantët dhe migrantet

Këtu mund të informoheni mbi “rregullat e lojes” në tregun austriak të punës, mbi fushat ose degët profesionale të profileve të kualifikimit që dallohen nga ato të vendit të origjinës, mbi mundësitë e kualifikimit (të mëtejshëm) profesional, mundësitë e subvencionimit dhe mbi njohjen/nostrifikimin e kualifikimeve me të cilat keni ardhur.

Mund të konsultoheni mbi çështjet e punës dhe do të shoqëroheni gjatë kualifikimit dhe kualifikimit të mëtejshëm profesional si edhe në procedurat e njohjes.

Konsultimet ofrohen në gjuhën gjermane, boshnjake/kroate/serbe, kineze, angleze, franceze, polake, portugeze, ruse, sllovaqe, spanjole dhe çeke.

Kontakt:

Telefoni i shërbimit: 58 58 019

Adresa: 1020 Vjenë, Nordbahnstraße 36/shkalla 1/kati i 4-të – 3. Stock (në anën e majtë të ashensorit)

E-maili: kompetenzzentrum@migrant.at

Faqja e Internetit: www.migrant.at



AMS – Shërbimi i tregut të punës

Shërbimi i tregut të punës – i shkurtuar AMS – është ndërmarrja më e rëndësishme e shërbimeve në tregun austriak të punës. Ai ndërmjetëson forcat e punës për vende të lira dhe përkrah kërkuesit e punës dhe ndërmarrjet nëpërmjet konsultimeve, informacioneve, kualifikimeve dhe subvencionimeve financiare.

Që nga momenti kur keni të drejtë për të filluar një punë dhe dëshironi të punoni, mund të lajmëroheni te zyra e Shërbimit të tregut të punës kompetente për lagjen tuaj si person që kërkon punë.

Kontakt:

Telefoni i shërbimit: (01) 878 71

Të hënave deri të enjteve nga ora 7:30 deri në orën 16:00

Të premtëve nga ora 7:30 deri në orën 15:30

E-maili: ams.servicelinewien@ams.at

Faqja e Internetit: www.ams.at/wien



Dhoma e Punëtorëve Vjenë

Dhoma e Punëtorëve Vjenë (AK Wien) ka në Vjenë rreth 800.000 anëtarë – të gjithë punëtorët dhe nëpunësit si edhe punonjësit e lirë në Vjenë janë anëtarë të Dhomës së Punëtorëve Vjenë. Ajo përfaqëson interesat profesionalë, ekonomikë, socialë dhe kulturorë të anëtarëve të saj ndaj shtetit. Anëtarët e saj konsultohen dhe përfaqësohen falas në rast të problemeve të së drejtës së punës dhe sociale dhe në shumë çështje të tjera. Përveç kësaj Dhoma e Punëtorëve Vjenë ofron përkrahje financiare për kualifikimin e mëtejshëm profesional me bonon e saj të arsimit. Dhoma e Punëtorëve Vjenë ka degë në Ottakring, Floridsdorf dhe Liesing dhe është njëkohësisht Zyra e Dhomës Federale të Punëtorëve, të organizatës qendrore të të 9 dhomave të punëtorëve në krahinat federale.

Kontakt:

Telefoni i shërbimit: 01 50165 – 0

Faqja e Internetit: www.wien.arbeiterkammer.at



WKO Wien – Dhoma e Ekonomisë Vjenë

Dhoma e Ekonomisë Vjenë është përfaqësia ligjore e mbi 110.000 sipërmarrësve dhe ndërmarrjeve të Vjenës dhe ofron anëtarëve të saj shërbime të gjëra në të gjitha fushat tematike të rëndësishme: duke filluar nga konsultimet për krijimin e një firme dhe për çështje juridike deri te çështjet e përforcimit shoqëror dhe të përkrahjes në krijimin e bashkëpunimeve dhe të rrjeteve. Përveç kësaj, mbi 70.000 veta me punë të pavarur, punëmarrës dhe çirakë marrin pjesë në çdo vit në kurset e kualifikimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm të Dhomës duke e shndërruar Dhomën e Ekonomisë Vjenë në njëën prej organizatave më të mëdha të kualifikimit në Austri. Prandaj Dhoma e Ekonomisë Vjenë nuk është vetëm një institucion kompetent për t'u kontaktuar për sipërmarrësit dhe ata që duan të krijojnë një ndërmarrje, por për të gjithë që duan të shfrytëzojnë njëën prej ofertave më të mëdha dhe të gjëra të kualifikimit dhe të kualifikimit të mëtejshëm në Austri. Na vizitoni në faqjen tonë të Internetit dhe informohuni mbi shërbimet tona!

Kontakt:

Telefoni i shërbimit: 514 50 1050

Internet: www.gruenderservice.net
www.biwi.at
www.wifi.at